UDHËZIM
Nr. 4, datë 29.6.2026

PËR KOMUNITETET E ENERGJISË SË RINOVUESHME

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 21, pika 6, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme",

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim ka si qëllim të përcaktojë:

a) format ligjore të krijimit të komuniteteve të energjisë së rinovueshme;

b) kushtet e pjesëmarrjes së hapur dhe vullnetare në komunitetet e energjisë së rinovueshme;

c) masat për lehtësimin e aksesit në financim, informacion dhe mbështetje rregullatore për këto komunitete;

ç) masat për nxitjen, zhvillimin dhe mbështetjen e komuniteteve të energjisë së rinovueshme nga autoritetet publike kompetente;

d) çështje të tjera të nevojshme për zbatimin dhe funksionimin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme.

2. Ky udhëzim zbatohet për:

a) të gjitha format e energjisë së rinovueshme dhe sektorët që mbulohen nga ligji për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, duke përfshirë konsumin e energjisë së rinovueshme në sektorët e energjisë elektrike, ngrohjes dhe ftohjes, dhe transportit;

b) subjektet juridike dhe fizike që krijojnë ose që marrin pjesë në komunitete të energjisë së rinovueshme;

c) komunitetet e energjisë së rinovueshme, si entitete të organizuara sipas legjislacionit në fuqi;

ç) operatorët e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, referuar detyrimeve për akses, lidhje dhe bashkëpunim me komunitet e energjisë;

d) autoritetet publike me kompetenca në fushën e energjisë.

3. Për qëllime të këtij udhëzimi termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "**Komunitet i energjisë së rinovueshme**" (KER) nënkupton një entitet juridik:

i. i cili, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, bazohet në pjesëmarrjen e hapur dhe vullnetare, është i pavarur dhe kontrollohet efektivisht nga aksionarët ose anëtarët që ndodhen në afërsi të projekteve të energjisë së rinovueshme, të cilat janë në pronësi dhe janë zhvilluar nga ai entitet juridik;

ii. në të cilin aksionarët ose anëtarët janë persona, ndërmarrje të vogla ose të mesme, autoritete lokale, duke përfshirë bashkitë;

iii. qëllimi kryesor i të cilit është të sigurojë përfitime mjedisore, ekonomike ose sociale për aksionarët, anëtarët e tij ose për zonat lokale ku operon, në vend të fitimeve financiare;

b) "**Anëtar**" është çdo individ, person fizik ose juridik, ose bashki që ka nënshkruar marrëveshjen e anëtarësimit;

c) "**Marrëveshje e anëtarësimit**" është marrëveshja e lidhur mbi bazën e marrëveshjes tip që rregullon të drejtat e detyrimet e anëtarëve në komunitetin e energjisë së rinovueshme, e hartuar nga ERE;

ç) “Ndarje e energjisë” është transferimi i energjisë së rinovueshme brenda një komuniteti të energjisë së rinovueshme, që prodhohet nga njësitë prodhuese në pronësi të atij komuniteti të energjisë së rinovueshme;

d) “**Klient në nevojë**” është një klient familjar i identifikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë të energjisë elektrike dhe varfërinë energjetike, duke marrë parasysh, ndër të tjera, nivelin e të ardhurave, raportin e shpenzimeve të energjisë ndaj të ardhurave të disponueshme të familjes, efikasitetin energjetik të banesës, moshën, gjendjen shëndetësore, varësinë nga pajisjet mjekësore që funksionojnë me energji elektrike, aftësinë e kufizuar ose kritere të tjera socio-ekonomike të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar;

dh) “**Familje me të ardhura të ulëta**” është një familje, të ardhurat e disponueshme të së cilës janë nën pragun e përcaktuar nga legjislacioni kombëtar në fuqi për identifikimin e familjeve që përfitojnë masa të mbrojtjes sociale, masa për trajtimin e varfërisë energjetike ose skema të tjera mbështetjeje të bazuara në të ardhura.

4. Rregullat dhe procedurat e detajuara që zbatohen për komunitetet e energjisë së rinovueshme që operojnë në të gjitha format e energjisë së rinovueshme dhe sektorët e përcaktuar në pikën 2, përveç sektorit të energjisë elektrike, miratohen me akt të veçantë nga ministria.

II. FORMAT LIGJORE TË KRIJIMIT

1. Komunitetet e energjisë së rinovueshme krijohen në një nga format juridike të parashikuar nga legjislacioni shqiptar, si më poshtë:

a) në çdo formë juridike të njohur nga legjislacioni shqiptar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, korporatat, shoqëritë e bashkëpunimit, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, shoqëritë aksionare ose persona të tjerë juridikë;

b) organizatë jofitimprurëse sipas legjislacionit për organizatat jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë.

2. Zgjedhja e formës ligjore është e lirë.

3. Pavarësisht nga forma juridike e zgjedhur, statuti ose akti i themelimit të komunitetit të energjisë së rinovueshme duhet të sigurojë, që:

a) qëllimi i tij parësor është të ofrojë përfitime mjedisore, ekonomike ose sociale për komunitetin, për anëtarët, aksionarët e tij ose për zonat ku ushtron veprimtarinë, në vend të fitimeve financiare;

b) pjesëmarrja është e hapur dhe vullnetare, ndërsa kushtet për pranimin, tërheqjen dhe anëtarësimin janë objektive, transparente dhe jodiskriminuese;

c) kontrolli efektiv ushtrohet ekskluzivisht nga anëtarët ose aksionarët që plotësojnë kërkesat e afërsisë të përcaktuara në këtë udhëzim;

d) komuniteti i energjisë së rinovueshme mbetet autonom dhe nuk kontrollohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga persona ose subjekte që nuk plotësojnë kërkesat e zbatueshme për komunitetet e energjisë së rinovueshme;

e) çdo transferim i aksioneve, kuotave, të drejtave të votës ose interesave të tjerë të pronësisë nuk duhet të çojë në humbjen e përputhshmërisë me kërkesat e zbatueshme për komunitetet e energjisë së rinovueshme.

4. Një subjekt juridik privat mund të jetë anëtar i një komuniteti të energjisë së rinovueshme, me kusht që pjesëmarrja e tij në komunitetin e energjisë së rinovueshme të mos përfaqësojë veprimtarinë e tij kryesore tregtare ose profesionale dhe të mos cenojë autonominë, kontrollin efektiv ose qëllimin e komunitetit të energjisë së rinovueshme për të sjellë përfitime për komunitetin.

5. Komunitetet e energjisë së rinovueshme njoftojnë ERE-n për çdo ndryshim në statutet e tyre, strukturën e aksionarëve, strukturën e anëtarësimit ose mekanizmat e qeverisjes, i cili mund të ndikojë në përmbushjen e kërkesave të zbatueshme për komunitetet e energjisë së rinovueshme.

6. Çdo klient fundor ka të drejtë të bëhet anëtar i komunitetit të energjisë së rinovueshme dhe të ruajë statusin e klientit fundor, si dhe statusin e klientit aktiv, me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër përkatës. Klienti fundor nuk do t'u nënshtrohet kushteve ose procedurave të pajustifikuara ose diskriminuese që pengojnë pjesëmarrjen e tij në një komunitet të energjisë së rinovueshme, me kusht që, për subjektet juridik private, pjesëmarrja e tyre të mos jetë veprimtaria e tyre kryesore tregtare ose profesionale.

7. Një komunitet i energjisë së rinovueshme ka të drejtë, të:

a) prodhojë, konsumojë, depozitojë, ndajë, shesë energji të rinovueshme dhe ofrojë agregim, duke përfshirë edhe marrëveshjet e shitblerjes së energjisë;

b) ketë akses në të gjitha tregjet e përshtatshme të energjisë, drejtpërdrejtë ose përmes agregimit, në mënyrë jodiskriminuese, në lidhje me aktivitetet, të drejtat dhe detyrimet e tyre si klientë fundorë, prodhues, furnizues, operatorë të sistemit të shpërndarjes ose si pjesëmarrës të tjerë të tregut.

8. Çdo komunitet i energjisë së rinovueshme do t'i mundësojë dhe do të stimulojë familjet me të ardhura të ulëta ose në nevojë të bëhen anëtare.

9. Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme janë të detyruara të investojnë 75% të fitimeve të tyre vjetore në veprimtari që mbështesin përmbushjen e qëllimit të tyre parësor, duke përfshirë zhvillimin e projekteve të energjisë së rinovueshme, depozitimin e energjisë, ndarjen e energjisë, masat për eficiencën e energjisë, përmirësimet e eficiencës energjetike në ndërtesa, si dhe iniciativa të tjera me përfitime mjedisore, ekonomike ose sociale për komunitetin, që u sjellin vlerë anëtarëve, aksionarëve të tyre ose zonave ku ato ushtrojnë veprimtarinë.

10. Komuniteti i Energjisë së Rinovueshme, në çdo rast, është i detyruar të respektojë rregullat e tregut, kodet e rrjetit të miratuara nga ERE, si dhe kushtet e operimit të tij sipas këtij udhëzimi.

11. Komuniteti i Energjisë së Rinovueshme regjistrohet në regjistrin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme, i cili administrohet dhe publikohet nga ERE në faqen e saj zyrtare të internetit.

12. Komuniteti i Energjisë së Rinovueshme paraqet një kërkesë për regjistrim në ERE, e cila shoqërohet me dokumentacion, si vijon:

a) statutin e shoqërisë dhe aktin e themelimit;

b) marrëveshjen me operatorin e sistemit për përdorimin e rrjetit;

c) përshkrimin e aktivitetit, përfshirë dhe pa u limituar në format dhe mënyrat e prodhimit, konsumit, depozitimit, ndarjes, shitjes së energjisë së rinovueshme dhe ofrimit të agregimit;

ç) përshkrimin e centralit prodhues dhe të pajisjeve dhe instalimeve të planifikuara;

d) hartën e vendndodhjes së pajisjeve dhe instalimeve të planifikuara;

dh) komunitetet e energjisë së rinovueshme me kapacitet të instaluar mbi 100 kw duhet të paraqesin, gjithashtu, planin e biznesit me vlerësim teknik dhe financiar për pesë vitet e para;

e) pagesën e regjistrimit, e cila miratohet nga ERE në përputhje me parimin e mospengimit të krijimit të komuniteteve të energjisë së rinovueshme;

ë) datën e parashikuar të vënies në operim.

13. ERE shqyrton kërkesën në përputhje me rregullat e thjeshtuara për regjistrimin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme dhe brenda 20 (njëzetë) ditëve pune, miraton ose refuzon në mënyrë të arsyetuar kërkesën.

14. Në rast se dokumentacioni është i paplotë, ERE kërkon plotësimin e tij brenda një afati të arsyeshëm, i cili nuk tejkalon 10 (dhjetë) ditë pune.

15. Në rast të miratimit të kërkesës, ERE brenda 3 (tre) ditësh pune regjistron KER-in në regjistrin e saj.

16. Komuniteti i energjisë së rinovueshme i fillon operimin vetëm pas regjistrimit në Regjistrin e Komuniteteve të Energjisë.

17. ERE ka të drejtë të pezullojë një komunitet të energjisë së rinovueshme nga Regjistri i Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme, në rast se konstatohet se:

a) nuk përmbush më kushtet ligjore për funksionimin si komunitet i energjisë së rinovueshme;

b) shkel rregullat e tregut të energjisë elektrike ose kodet e rrjetit;

c) nuk përmbush detyrimet e raportimit ndaj ERE-s;

ç) paraqet të dhëna të pasakta, të paplota ose mashtruese;

d) ushtron veprimtari në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në fushën e energjisë.

18. Në çdo rast, një Komuniteti i energjisë së rinovueshme mund të kërkojë çregjistrimin nga regjistri i ERE-s, kjo e fundit brenda 3 (tre) ditësh pune merr masa për heqjen nga regjistri.

III. KUSHTET E PJESËMARRJES NË KOMUNITETET E ENERGJISË SË RINOVUESHME

1. Anëtarësimi në çdo Komunitet të energjisë së rinovueshme duhet të jetë i hapur, vullnetar dhe i aksesueshëm për të gjithë konsumatorët, përfshirë konsumatorët nga familje me të ardhura të ulëta ose familje në nevojë. Asnjë kufizim arbitrar i anëtarësimit nuk lejohet.

2. Çdo anëtar ka të drejtë të tërhiqet me njoftim paraprak prej 30 (tridhjetë) ditësh, pa penalitete, me kusht shlyerjen e plotë të detyrimeve financiare të lindura gjatë periudhës së anëtarësimit.

3. Anëtarët e Komunitetit të energjisë së rinovueshme ruajnë të gjitha të drejtat e tyre si klientë fundorë ndaj furnizuesit të energjisë elektrike.

4. Çdo anëtar nënshkruan marrëveshjen e anëtarësimit, bazuar në marrëveshjen tip të hartuar nga ERE, e cila përmban të paktën:

a) të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve;

b) format dhe mënyrat e prodhimit, konsumit, depozitimit, ndarjes, shitjes së energjisë së rinovueshme dhe ofrimit të agregimit në përputhje me ligjin "Për sektorin e energjisë elektrike", duke përfshirë edhe marrëveshjet e shitblerjes së energjisë;

c) kushtet dhe procedurat e tërheqjes nga komuniteti;

ç) kushte të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet rregullatore dhe aktet e tjera të KER-it.

5. Në kuadër të përkufizimit të përcaktuar në kreun I, pika 3, shkronja "a", të këtij udhëzimi, aksionarët ose anëtarët do të konsiderohen se ndodhen në afërsi të një projekti të energjisë së rinovueshme kur ata ndodhen në të njëjtën bashki me projektin e energjisë së rinovueshme dhe janë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet të njëjtit nënstacion të shpërndarjes ose nëpërmjet një konfigurimi të ngjashëm të rrjetit të shpërndarjes të përcaktuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për t'i shërbyer të njëjtës zonë. Në raste të jashtëzakonshme, ERE mund të njohë bashki fqinje ose zona furnizimi fqinje, kur karakteri lokal i Komunitetit të Energjisë së Rinovueshme ruhet.

IV. ORGANIZIMI, KONTROLLI DHE MBËSHTETJA

1. Komuniteti i energjisë së rinovueshme organizohet si person juridik dhe ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë autonome, në përputhje me aktin themelues dhe statutin e tij. Komuniteti i Energjisë së Rinovueshme ka organe drejtuese dhe struktura përgjegjëse, për:

a) drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së tij;

b) menaxhimin teknik të instalimeve dhe pajisjeve;

c) menaxhimin financiar dhe raportimin.

2. Vendimet e Komunitetit të energjisë së rinovueshme merren në përputhje me aktet statutore, bazuar në parimin “një anëtar, një votë”.

3. Komuniteti i energjisë së rinovueshme ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë atë fiskal dhe të kontabilitetit, si dhe mban dokumentacionin përkatës sipas kërkesave ligjore.

4. Komuniteti i energjisë së rinovueshme i raporton ERE-s, brenda datës 31 janar të çdo viti, mbi:

a) sasinë e energjisë së prodhuar, depozituar, ndarë, ofruar agregatorit, konsumuar dhe shitur gjatë vitit paraardhës;

b) numrin e anëtarëve aktivë;

c) gjendjen financiare;

ç) planin e investimeve për vitin, ku të jetë parashikuar pjesa e fitimit vjetor, e cila do të destinohet për qëllime të rritjes së vetëprodhimit, eficiencës së energjisë dhe eficiencës së energjisë në ndërtesa, me qëllim arritjen e standardit të konsumit net zero të energjisë elektrike ose energjisë së marrë nga rrjeti energjetik;

d) kushtet, formën dhe mënyrën e promovimit të anëtarësimit të familjeve me të ardhura të ulëta dhe klientëve në nevojë në Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme;

dh) koordinimin me institucionet të cilat ushtrojnë veprimtari sipas legjislacionit për eficiencën e energjisë dhe performancën energjetike në ndërtesa.

5. ERE publikon këto të dhëna në mënyrë të agreguar në raportin e saj vjetor dhe në faqen zyrtare të internetit.

6. Ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, krijon dhe zbaton masa për të lehtësuar aksesin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme në burime financiare, në mënyrë të drejtë, transparente dhe jodiskriminuese, të cilat përfshijnë, ndër të tjera:

a) lehtësimin e aksesit në skemat kombëtare dhe ndërkombëtare të financimit, përfshirë programet e Bashkimit Evropian dhe institucionet financiare ndërkombëtare;

b) promovimin e instrumenteve financiarë të përshtatshëm për komunitetet e energjisë së rinovueshme;

c) Në hartimin dhe zbatimin e skemave mbështetëse, programeve dhe masave që nxisin energjinë nga burimet e rinovueshme, autoritetet kompetente duhet të marrin parasysh karakteristikat specifike të komuniteteve të energjisë së rinovueshme, me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes së tyre në kushte të barabarta me pjesëmarrësit e tjerë të tregut. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente mund të marrin në konsideratë masa proporcionale që synojnë trajtimin e pengesave administrative, teknike, financiare dhe organizative që mund të ndikojnë në mënyrë joproporcionale komunitetet e energjisë së rinovueshme, duke garantuar njëkohësisht transparencën, objektivitetin, mosdiskriminimin dhe pajtueshmërinë me rregullat në fuqi për ndihmën shtetërore.

7. Ministria përgjegjëse për energjinë siguron akses në informacion të plotë dhe të përditësuar për komunitetet e energjisë së rinovueshme, përfshirë:

a) udhëzime dhe materiale informuese;

b) modele dokumentesh dhe praktikash standarde;

c) informacion mbi mundësitë e financimit dhe mbështetjes.

8. Informacioni i referuar në pikën 7 të këtij kreu, publikohet dhe përditësohet rregullisht në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për energjinë.

9. Ministria përgjegjëse për energjinë ofron trajnime dhe asistencë teknike për autoritetet publike vendore dhe qendrore, që dëshirojnë të mbështesin ose të marrin pjesë drejtpërdrejtë në komunitete të energjisë së rinovueshme.

10. Bashkitë mund të bëhen anëtarë të komuniteteve të energjisë së rinovueshme vetëm brenda territorit të tyre administrativ.

V. ÇËSHTJE TË TJERA

1. Komunitetet e energjisë së rinovueshme janë subjekt i tarifave të rrjetit në mënyrë drejtë, proporcionale dhe të bazuara në kostot reale, të miratuara nga ERE, si dhe tarifave, detyrimeve dhe taksave përkatëse, duke garantuar që ato të kontribuojnë, në mënyrë të përshtatshme, të drejtë dhe të balancuar, në ndarjen e kostove të përgjithshme të sistemit, në përputhje me një analizë transparente kosto-përfitim të burimeve të shpërndara të energjisë, të përgatitur nga ERE.

2. Operatori i rrjetit është i detyruar të trajtojë kërkesat e komuniteteve të energjisë së rinovueshme për lidhje në rrjet pa diskriminim dhe brenda afateve të parashikuara në rregulloren për lidhjet e reja. Projektet demonstruese të komuniteteve të energjisë së rinovueshme me kapacitet të instaluar më të vogël se 10,8 kw përfitojnë nga procedura të lehtësuara për lidhjen me rrjetin, nëpërmjet paraqitjes së një njoftimi për lidhjen me rrjetin pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

3. Operatori i rrjetit bashkëpunon me komunitetet e energjisë së rinovueshme në lehtësimin e transferimeve të energjisë brenda komuniteteve të energjisë së rinovueshme, duke përfshirë sigurimin e rregullimeve teknike dhe operacionale të nevojshme për zbatimin e mekanizmave të zbatueshëm të shpërndarjes së energjisë.

4. Mosmarrëveshjet ndërmjet komuniteteve të energjisë së rinovueshme dhe operatorit të rrjetit zgjidhen nga ERE, në përputhje me përcaktimet e rregullores përkatëse për trajtimin e ankesave nga klientët dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike.

5. Komunitet e energjisë së rinovueshme trajtojnë të dhënat personale sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Krijimi dhe administrimi i regjistrit të komuniteteve të energjisë së rinovueshme nga ERE, realizohet brenda 3 (tri) muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

2. Rregullat për regjistrimin dhe pezullimin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme, përfshirë pagesën e regjistrimit miratohen nga ERE brenda 3 (tri) muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

3. Metodologjia teknike dhe financiare e ndarjes së energjisë brenda komuniteteve të energjisë së rinovueshme, format dhe mënyrat e ndërveprimit me operatorët e rrjetit, dhe tarifat e regjimit të rrjetit, si dhe kufizimet përkatëse, me përjashtim të çështjeve fiskale, miratohen nga ERE, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

4. Ministria, në bashkëpunim me ERE, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, kryen një vlerësim të pengesave kryesore dhe zhvillimin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme në territoret e tyre.

5. Aktet rregullatore të përcaktuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij kreu, duhet të marrin në konsideratë praktikat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe udhëzimet e Komisionit Evropian.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Enea Karakaçi